



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA**

**KUVENDI / SKUPŠTINA /ASSEMBLY**

**Legjislatura e III-të**

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji,  
Kulturë, Rini e Sport  
Mbledhja e dytë, dt.28.02.2008  
Salla nr. N.10 ora 14,00  
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

**PROCESVERBAL**

Nga mbledhja e komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport

Në mbledhje morën pjesë: Agim Veliu, Drita Kadriu, Enis Kervan, Memli Krasniqi, Vlora Çitaku, Adem Hajdaraj, Arsim Rexhepi, Fatmire Berisha dhe Donika Kadaj-Bujupi.  
Mungoi Mark Krasniqi.

Nga sekretaria e Kuvendit morën pjesë: Lule Ymeri, zyrtare ligjore dhe Mirjeta Heta asistente administrative.

Mbledhjen e udhëhoqi Agim Veliu, kryetar i Komisionit.  
Për këtë mbledhje është paraparë ky:

**Rend dite**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Shqyrtimi i Projektligjit për provimin përfundimtar dhe të maturës
3. Të ndryshme.

Rendi i ditës u miratua nga anëtarët e Komisionit.

1. Procesvarbali i mbledhjes së kaluar u miratua pa vërejtje.

## 2. Shqyrtimi i Projektligjit për provimin përfundimtar dhe të maturës

Kryetari i Komisionit **Agim Veliu**, i njoftoi anëtarët e Komisionit se Projektligji për provimin përfundimtar dhe të maturës është hartuar dhe miratuar nga Qeveria e kaluar, por për shkak të pamundësisë së përfundimit të tij për shkak të kohës së shkurtër, i njëjti projektligj është proceduar në Kuvend në këtë legjislaturë.

Sipas kryetarit të Komisionit rëndësia e nxjerrjes së këtij projektligji qëndron në faktin që të rregullohet me ligj çështja e provimit përfundimtar dhe të maturës.

**Adem Hajdaraj**, tha se provimi përfundimtar është paraparë mirë me projektligj, ndërsa provimi i maturës duhet të bëhet me gojë para Komisionit përkatës. Heqja e provimit pranues në Universitet është në kundërshtim me Statusin e Universitetit, sepse duhet të bëhet seleksionimi me rastin e pranimit.

**Arsim Rexhepi** mendon se provimi i maturës është një çështje që duhet të kushtohet rëndësi e posaçme ngase sipas tij është bosht kryesor i institucioneve të arsimit, ndërsa sa i përket provimit pranues kjo duhet të hiqet ashtu siq parashihet në shumicën e vendeve të tjera.

**Memli Krasniqi** e përkrah projektligjin në parim, mendon që me fillimin e amendamentimit duhet plotësuar dispozitat ku parashihen kriteret e provimit të maturës.

Anëtarët e Komisionit ishin të mendimit që ky projektligj në përgjithësi i plotëson kushtet për miratim në parim dhe u zotuan që si Komision do të japin kontributin e tyre në plotësimin dhe amendamentimin e tij me qëllim të eliminimit të zbrastësive eventuale.

## 3. Të ndryshme

Mbledhja e ardhshme e Komisionit do të caktohet javën e ardhshme

Mbledhja përfundoi në orën 14,30

Kryetari i Komisionit,  
Agim Veliu